



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. "George Bush", Ndërtesa e Rektoratit, Nr. 31, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 5/200  
Data: 29 / 11 / 2024

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kushtet e përcaktuara sipas Rregullores nr. 2/506, datë 24.10.2023 për studimet e doktoratës, konkursit nr. 2/782 të datës 20.09.2024 të shpallur nga Universiteti i Prishtinës, për pranimin e studentëve në studime të doktoratës, për vitin akademik 2024/25, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.11.2024, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet rekomandimi i Këshillit Qendror për Studime të Doktoratës për miratim të listave përfundimtare të kandidatëve për pranim në studime të doktoratës në vitin akademik 2024/25, sipas propozimit të njësisë akademike përkatëse: Fakultetit Mjekësisë, Fakultetit Edukimit dhe FIEK.
- II. Kandidatët e pranuar në studime e doktoratës për vitin akademik 2023/24, do të regjistrohen me hyrje në fuqi të këtij vendimi.
- III. Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit (Ndërtesa e Bibliotekës Qendrore Universitare).
- IV. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
  - Fletëregjistrimin e plotësuar (i cili shkarkohet nga SEMS);
  - Dy fotografi të formatit 6x4cm;
  - Fletëpagesën (e cila shkarkohet nga SEMS);
  - Pagesa bëhet në njërin prej bankave afariste.
- V. Data e fillimit të ligjëratave caktohet nga njësit akademike përkatëse.
- VI. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë listat e kandidatëve të pranuar përkatësisht lista me nr. prot: 16084, dt: 22.10.2024 e Fakultetit të Mjekësisë, lista me nr. prot: 04/2347 dt. 22.10.2024, e Fakulteti të Edukimit dhe lista me nr. prot: 4/368 dt. 12.11.2024 e FIEK-ut.
- VII. Obligohen njësit akademike përkatëse që këtë vendim ta publikojnë në ueb faqen e njësisë akademike.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**A r s y e t i m**


Këshilli Qendror për Studime të Doktoratës, në mbledhjen e mbajtur me 22.11.2024, ka shqyrtuar raportet përfundimtare të Fakultetit Edukimit, Fakultetit të Mjekësisë dhe FIEK, si dhe listat e kandidatëve të propozuar për pranim në studime të doktoratës për vitin akademik 2024/25.

KQSD, gjithashtu ka shqyrtuar zbatimin e procedurave ligjore të konkursit dhe Rregullores në fuqi për studime të doktoratës nga ana e njësive akademike të specifikuara në paragrafin 1 të dispozitivit të këtij vendimi dhe ka konstatuar se janë respektuar procedurat e përcaktuara sipas konkursit nr. 2/728 të datës 20.09.2024 dhe Rregullores nr. 937 dt: 26.04.2023, për studime të doktoratës. Senati i Universitetit të Prishtinës, mbështetur në argumentet e sipërsënuara, bazuar dhe në rekomandimin e KQSD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Këshillë juridike:*** Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura, mund të parashtrojnë ankesë, në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit në web faqen e universitetit. Palët ankesën e drejtojnë në njësinë akademike përkatëse, pastaj njësia akademike përkatëse e procedon ankesën pranë Komisionit për Ankesa dhe Parashtrësa të Senatit të UP-së.

**Vendimi t'u dorëzohet:**

1. Arkivit të UP-së;
2. Zyrës Ligjore të UP-së;
3. Dekanëve të njësive akademike përkatës;
4. Shërbimit financiar të UP-së;
5. Menaxhmentit të UP-së;
6. ZÇA-së;
7. Shërbimit të Studentëve;



Prof. Arben Hajrullahu

Rektor i UP-së